

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Teuta Krusha me pjesëmarrjen e sekretares juridike Teuta Spahiu procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit A. S. nga Prizreni, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm nën numrin PP/II.nr.590-6/2016 të datës 10.11.2016, pas mbajtjes së seancës fillestare në praninë e prokurorit të shtetit Musli Gashi dhe të akuzuarit, me datë 03.11.2017 publikisht morri dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

A. S. nga i ati R. dhe e ëma H. e lindur M., i lindur më datë *data e lindjes...* në Prizren ku edhe tani jeton rruga ... nr..., ka të kryer shkollën e mesme, punëtor në tregti - shitës, i martuar, baba i katër fëmijëve, me numër personal *numri personal...*, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, gjendjes së varfër ekonomike.

ËSHTË FAJTOR

Me datë 23.02.2016 rreth orës 15:45 minuta, në Prizren në udhëkryqin ku kryqëzohen rrugët ... dhe ...”, si pjesëmarrës në komunikacionin rrugor nga pakujdesia rrezikon trafikun publik, jetën e njerëzve dhe pasurinë e pjesëmarrësve tjerë në komunikacion, vepron në kundërshtim me nenin 34 dhe 150 të LSKRR, në atë mënyrë që duke e drejtuar automjetin e markës “Opel Corsa” me targa të regjistrimit *numri i targës...*, kur arrin në vendin kritik para barnatores “V.” merr veprim të pasigurt për kthimin mbrapa dhe si pasojë e vozitjes së pakujdesshme me pjesën e pasme të automjetit e godet këmbësorin – të dëmtuarin M. S. i cili merr lëndime trupore dhe atë: ndrydhje të indeve të buta në regjionin e kërdhokullës së majtë të cilat lëndime kanë karakterin e lëndimit të lehtë trupor me pasoja të përkohshme për shëndetin.

Kësodore ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPK.

Gjykata në bazë të nenit 7, 41, 49, 50, 51, 73 dhe nenit 378 par.6 lidhur me par.1 të KPK i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Vërteton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat prej 1 (një) viti, nuk kryen vepër të re penale.

I dëmtuari M. (R.) S. nga Prizreni rruga ... nr..., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Obligohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës dhe atë në emër të ekspertizës për ekspertin e komunikacionit shumë prej 30.66 €, në emër të

shpenzimeve të ekspertit mjeko ligjore për ekspertizë shumen prej 20 €, kurse në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 €, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

Mbikëqyrjen e dënimit me kusht do të bëjë Shërbimi Sprovues në Prizren në pajtim me nenin 159 par.1 të LESP.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i përgjithshëm, ka parashtruar aktakuzë nën numrin PP/II.nr.590-6/2016 të datës 10.11.2016, kundër të akuzuarit A. S. nga Prizreni, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPK.

Gjykata në seancën fillestare në prezencën e palëve pasi që u lexua aktakuza nga ana e prokurorit të shtetit, i shpalosi dhe bëri prezantimin e të gjitha provave materiale në të cilat mbështetet aktakuza e parashtruar ndaj të akuzuarit. I akuzuari nuk e kundërshtoj provat materiale të cilat janë pjesë e shkresave të lëndës dhe pranoj fajësinë për veprën penale me të cilën ngarkohet.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Ditën kritike me datë 23.02.2016 rreth orës 15:45 minuta, në Prizren tek udhëkryqi ku kryqëzohen rrugët ... dhe , i akuzuari A. S. si pjesëmarrës në komunikacionin rrugor, gjatë drejtimit të automjetit të markës “Opel Corsa” me targa të regjistrimit *numri i targë...*, kur arrin në vendin kritik para barnatore “V.”, shkel ligjin mbi trafikun publik, vepron në kundërshtim me nenin 34 dhe 150 të LSKRR, merr veprim të pasigurt për kthimin mbrapa si pasojë e vozitjes së pakujdesshme me pjesën e pasme të automjetit e godet këmbësorin – të dëmtuarin M. S. i cili merr lëndime trupore dhe atë: ndrydhje të indeve të buta në regjionin e kërdrhokullës së majtë, të cilat lëndime kanë karakterin e lëndimit të lehtë trupor me pasoja të përkohshme për shëndetin.

Gjykata para se të hap seancën fillestare – paraprakisht bëri shikimin e shkresave të lëndës dhe bëri analizën e provave materiale dhe atë: ekspertizën e ekspertit të komunikacionit Inxhinier Sami Fusha të datës 09.04.2016, ekspertizën e ekspertit të mjeksisë ligjore Dr. F. B. të datës 03.06.2016, raporti mjeksësor i Spitalit Rajonal në Prizren – Qendrës Emergjente me numër të protokollit 1413 të datës 23.02.2016, skicën e vendit të ngjarjes dhe foto dokumentacionin, me ç’rast është vërtetuar se provat janë marrë në pajtim me dispozitat e kodit të procedurës penale dhe aktakuzën e prokurorit të shtetit e bëjnë të qëndrueshme dhe e bazuar në ligj. Provat në fjalë me kohë janë parashtruar të akuzuarit me qëllim që të njëjtat të kundërshtoj dhe të parashtroj prova tjera të cilët do të shkojnë në favor të gjendjes faktike dhe mbrojtjes së tij. Mirëpo në seancën fillestare pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit i akuzuari deklaroj se ka kuptuar aktakuzën dhe nuk e kundërshton provat në të cilat mbështete aktakuza dhe e pranon fajësinë për veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPK. Prandaj pasi që i akuzuari në seancën fillestare pranoj fajësisë dhe ky pranim është bërë pa kushtëzim dhe vullnetarisht, e cila mbështet në fakte dhe prova materiale, gjykata konsideroj se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 246 të KPPK dhe ka ardhur në përfundim se në veprimet e akuzuarit formohen të gjitha elementet qenësore të veprës penale e përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe të gjykoj në bazë të ligjit, duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin gjykata i morri parasysh të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPK, të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, pasi që gjykata nuk ka gjetur asnjë rrethanë rënduese, ndërsa si rrethana lehtësuese për të akuzuarin morri parasysh faktin se ka pranuar fajësinë dhe ka tregu bashkëpunimi me organet e drejtësisë, sjellja korrekte e akuzuarit gjatë zhvillimit të procedurës, pendimi për kryerjen e veprës penale, gjendja materiale dhe statusore – është i gjendjes së dobët ekonomike dhe është mbajtës i vetëm i familjes, kjo është hera e parë që bie ndesh me ligjin, andaj bazuar në të gjitha këto gjykata i shqiptoj dënimin si në shqiptim të këtij aktgjykimi duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të përmbahet nga veprimet e tilla, me bindje se është proporcionale me peshën e veprës penale për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor.

Vendimi mbi udhëzimin e dëmtuarit në kontest të rregullt civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike, gjykata morri në pajtim me nenin 463 par.1 e 2 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në kuptim të nenit 453 par.1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.2506/2016 të datës 03.11.2017

Procesmbajtësja
Teuta Spahiu

Gjyqtarja
Teuta Krusha

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimin, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.